



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1189 Prot.

Tiranë, më datë 29.07.2021

VENDIM
Nr. 478, datë 28.07.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.07.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Sondazheve Arkeologjike dhe Konceptit të Gërmimit Arkeologjik të Shpëtimit në kuadër të projektit "Për riparimin dhe përforcimin e shkollës 9-vjeçare "Eftali Koçi", Loti 1, rruga "Prokop Meksi", brenda kufirit të Zonës Arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit", realizuar nga individi i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani, me aplikues "Arkimade sh.p.k" dhe zhvillues U.N.D.P.;
 - Për sondazhin numër 2 të realizohet gërmimi arkeologjik i shpëtimit për strukturën e evidentuar gjatë sondazheve;
 - Për pjesën tjetër të projektit të vijojë zbatimin i punimeve në monitorimin arkeologjik, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe.
 2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin zhvillimor me objekt "Për riparimin dhe përforcimin e shkollës 9-vjeçare "Eftali Koçi", Loti 1, rruga "Prokop Meksi", Durrës", si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
 4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI